



Përmbledhja në një gjuhë të thjeshtë

Programi i Asistencës Financiare për Pacientin (FAP)

Misioni i Qendrës Shëndetësore Komunitare e South Boston ("Qendra Shëndetësore") është sigurimi i shërbimeve me cilësi të lartë për të gjithë pacientët, pavarësisht nga statusi dhe mundësia për të paguar. Vizioni ynë është plotësimi i nevojave shëndetësore të komunitetit duke siguruar në vazhdimësi kujdes me cilësi të lartë, duke vënë theksin në kujdesin parësor ose parandalues. Ne përpiqemi të jemi në krye të komunitetit për sa u përket çështjeve shëndetësore, duke i dëgjuar dhe duke i mësuar me respekt, përkushtim dhe ekspertizë klinike si dhe duke i kushtuar gjithmonë vëmendje të veçantë asaj pjese të popullsisë që është më e prekshme.

Qendra do të ndihmojë personat e pasiguruar dhe me sigurim të pamjaftueshëm të aplikojnë dhe të regjistrohen për mbulimin shëndetësor nëpërmjet programit të asistencës publike (përfshi por jo kufizuar vetëm me MassHealth, programin e asistencës për pagesën e primit, që operohet nga Health Connector, Children's Medical Security Program (Programi i Sigurisë Mjekësore për Fëmijët), Health Safety Net dhe Medical Hardship) dhe/ose Financial Assistance Program (Programi i Asistencës Financiare të Qendrës), "Sliding Fee Discount Program" (Programi i Uljes së Tarifave sipas Nevojave) sipas rastit. Asistenca për këto programe përcaktohet nëpërmjet shqyrtimit, midis të tjerave, të të ardhurave familjare të individit, aseteve, numrit të pjesëtarëve të familjes, shpenzimeve dhe nevojave shëndetësore. Të gjithë pacientët që janë të pa siguruar ose me sigurim të pamjaftueshëm, kanë të drejtën të aplikojnë për programin Sliding Fee Discount të Qendrës.

Kujt i lind kjo e drejtë?

Pacientët me të ardhura të pakta që janë të pasiguruar ose me sigurim të pamjaftueshëm, të cilët plotësojnë kushtet për të ardhurat, kanë të drejtën e asistencës financiare. Asistenca financiare për këto programe përcaktohet nëpërmjet shqyrtimit, midis të tjerave, të të ardhurave familjare të individit, aseteve, numrit të pjesëtarëve të familjes, shpenzimeve dhe nevojave shëndetësore. Në rast se ju del e drejta, pacientëve nuk do t'ju kërkohet të paguajnë për shërbimet; të tjerëve mund t'ju kërkohet të bëjnë një pagesë të pjesshme. Një banor i Masaçusetsit, pavarësisht nga të ardhurat, mund të kualifikohet për Medical Hardship nëpërmjet Health Safety Net, në rast se shpenzimet mjekësore ia kanë pakësuar të ardhurat e tij në atë shkallë sa nuk është në gjendje të paguajë për shërbimet shëndetësore.

Si aplikohet:

Politika për ndihmën financiare e Qendrës Shëndetësore, politika e programit Sliding Fee Discount, aplikimi për programin Sliding Fee Discount dhe politika Patient Payment and Collections (për Pagesat dhe Mbledhjen e Pagesave), janë në dispozicion të të gjithë pacientëve në faqen në internet të Qendrës Shëndetësore: www.sbchc.org.

Kopje të këtyre politikave mund t'i gjeni gjithashtu në Departamentin e Këshillimit Financiar të Qendrës Shëndetësore në katin e parë të qendrës në adresën 409 West Broadway, ose mund të kërkonti që t'ju dërgohet një kopje me postë. Kërkesa mund të bëhet duke i telefonuar Departamentit të Këshillimit Financiar në numrin 61- 464 - 517 ose duke i drejtuar një kërkesë me shkrim Departamentit të Këshillimit Financiar në adresën e përmendur më sipër.

Për ata që nuk e kanë anglishten gjuhën e nënës, ju lutemi merrni Departamentin e Këshillimit Financiar në numrin e mëposhtëm dhe do t'ju sigurohet përkthimi në gjuhën tuaj.